

EKONOMIA RAJONALE E TROJEVE SHQIPTARE NË SHEK. XVI-XVIII MËS VENEDIKUT DHE PERANDORISË OSMANE

Dinamika e këtij zhvillimi ekonomik që përvijohet përmes kësaj qasjeje krahasuese, tregon se ekonomia e Ballkanit Jugperëndimor që në njëfarë mënyre i korrespondon trojeve shqiptare, në pikënisje të periudhës në studim, pra në shek. XVI dhe deri në gjysmën e shekullit XVII është më pak e zhvilluar se sa ekonomia e tërësisë së Perandorisë Osmane dhe e Venedikut, edhe pse ritmi i zhvillimit gjatë gjithë kësaj periudhe është i qëndrueshëm. Në mesin e shekullit XVII, ndërkohë që Republika e Venedikut njih një dekadencë ekonomike të shpejtuar, edhe tërësia e Perandorisë Osmane nis të njëjtën kurbë rënieje në gjysmën e dytë të shekullit XVII, ekonomia shqiptare jo vetëm vazhdon dinamikën e zhvillimit, por njih një ritëm më të vrullshëm të zhvillimit ekonomik krahasuar me periudhën e mëparshme, deri sa arrin pikën kulmore të zhvillimit ekonomik për periudhën osmane në fundin e shekullit XVIII dhe fillimin e shek. XIX, në periudhën e autonomizimit politik të pashallëqeve të Shkodrës e Janinës. Rënia e këtyre autonomeve politike shënon edhe fillimin e dekadencës së përshpejtuar ekonomike të trojeve shqiptare, mbas tre shekujsh të zhvillimit të qëndrueshëm, moment që shënon edhe cakun kohor të shqyrtimit tonë.

Fernand Braudel me punimin e tij mbi Mesdheun në shek. XVI dëshmoi mjeshtërisht unitetin e botës mesdhetare të këtij shekulli, përtej kufijve politikë, fetarë e kulturorë dhe i dha hov përdorimit të metodave sasiore për hulumtimin historik.⁽¹⁾ Në fillim të shek. XVII Italia Qendrore dhe Veriore vazhdonte të ishte një nga zonat më të zhvilluara të Europës Perëndimore me një standard të lartë jetese për kohën. Por nga fundi i të njëjtit shekull, pra rreth

¹ Fernand Braudel, *La Méditerranée et le monde méditerranéen à l'époque de Philippe II*, 2nd ed., vol. 12 (Paris, 1966).

vitit 1680, Italia ishte shndrruar në një vend të prapambetur dhe në depresion ekonomik të pandalshëm. Në Venecia prodhimi i tekstileve që përbënte edhe sektorin kryesor të ekonomisë, ra nga 29 mijë copë në vitin 1602, në vetëm dy mijë në fund të shekullit. E njëjta situatë dramatike përshkruhet për Kremonën, Moncën, Pavian dhe madje edhe për Gjenovën që qëndron jashtë sistemit ekonomik të Adriatikut dhe Ultësirës Padane.⁽²⁾ Akoma më tragjike përshkruhet situata për Napolin e Siçilinë. Kjo dekadencë përfshiu edhe sektorë të tjerë, si atë bankar, transportin detar dhe eksportet që pësuan një kolaps të plotë. Pyetjes se si mund të shpjegohet një kolaps kaq tragjik i ekonomisë italiane gjatë shek. XVII i janë dhënë përgjigje të ndryshme. Nga fundi i shek. XVII Italia importonte prodhime industriale në shkallë të gjerë nga Anglia, Franca e Holanda. Pra, ishte shndrruar nga një vend i zhvilluar që importonte lëndë të parë dhe eksportonte prodhime industriale dhe shërbime, në një vend të prapambetur duke bërë të anashjelltën.⁽³⁾

Nga këndvështrimi i historianëve venedikas zgjerimi i Perandorisë Osmane pati efekte pozitive dhe negative gjatë shek. XV. Kjo shkaktoi dobësimin e rivalëve të Venecias në Mesdheun Lindor dhe i mundësoi Venedikut që të zgjerojë akoma edhe më shumë perandorinë e saj koloniale. Osmanët nuk ua mbyllën dyert e tregtisë venedikasve. Thiriet shkon më tej duke e rishikuar këndvështrimin e vjetër mbi efektet e ngritjes së fuqisë osmane. Ai e paraqet krejt shekullin XV, madje edhe mbas pushtimit osman të Konstandinopojës dhe Moresë, si një periudhë prosperiteti të madh për kolonitë venedikase. Fitimet për tregtarët venedikas nuk u prekën nga zgjerimi osman përveç Detit të Zi, që gjithsesi edhe më përpara ishte një zonë ekskluzive gjenoveze. Sipas tij, mbas paqes së vitit 1479, u vendos një ekuilibër i ri mes të dyjave, që megjithatë ishte më i favorshëm për osmanët.⁽⁴⁾

² Carlo M. Cipolla, ed. *The Economic Decline of Empires*, London: Methuen, 1970, pp. 196-199.

³ Cipolla, *The Economic Decline of Empires*, pp. 200-203, 211-214.

⁴ Freddy Thiriet, *La Romanie Vénitienne au Moyen Age: le développement et l'exploitation du domaine colonial vénitienne, XIIIe-XVe siècles*. Paris: Éditions E. de Boccard, 1959, p. 429.

Luzatto thekson se ekspansioni në Italinë Veriore nuk ishte një shkuarje dëm energjish. Në shek. XVI-XVII ndodhën përshtatje-ripërshtatje ndaj presionit osman, ndaj konkurrencës së portugezëve, ndaj dinamikës së inflacionit, dhe vështirësive gjithnjë e më të mëdha të përballimit të shteteve gjigande si Franca e Spanja.⁽⁵⁾ Edhe Braudel krahason rritjen e saj me qendrat e tjera duke dalluar tri periudha: 1450-1500, 1500-1550, and 1550-1600.⁽⁶⁾

Ndërkohë që në shek. XVI dekadencia venedikase është relative, në shek. XVII është rasti tipik i fuqisë në dekadencë ekonomike. Të dhënat statistikore tregojnë një rritje ekonomike në vitet 1580-1590, por pikërisht gjatë dekadës së parë të shek. XVII Venediku u godit nga një sërë krizash, të cilat e shndrruan nga një fuqi ekonomike konkurruese në mesin e tregjeve botërore në një qendër regionale industriale e tregtare. Njëkohësisht francezët, anglezët dhe holandezët e tejkaluan Venedikun në tregtinë me Perandorinë Osmane dhe u bënë importuesit më të mëdhenj të pambukut osman.⁽⁷⁾

Një dinamikë e ngjashme e prek edhe shtetin osman pak më vonë. Në përgjithësi gjatë filleve të kohës së re, fatet e Venedikut dhe shtetit osman ishin të ndërthurura ngushtë në aspektin gjeografik, politik dhe ekonomik. Në aspektin ekonomik Venediku vazhdonte të ishte partneri më i rëndësishëm evropian i osmanëve deri në fillimin e shek. XVII. Nga fillimi i shek. XVI marrëdhëniet mes tyre u karakterizuan nga një bashkëjetesë paqësore, edhe pse vigjilente, me periudha të rralla e të shkurtra konflikti të hapur.⁽⁸⁾

⁵ Gino Luzzatto, "La Decadenza di Venezia dopo le scoperte geografiche nella tradizione e nella realta," *Archivio veneto*, Ser. v, LIV-LV (1954), p. 174.

⁶ "Venezia ha visto aumentare il suo peso specifico nel Cinquecento; ma non il suo peso relativo: e questa distinzione pone il problema della sua decadenza." Fernand Braudel, "La Vita economica di Venezia nel secolo XVI," *La Civiltà veneziana del Rinascimento*, Venezia: Fondazione Giorgio Cini and Sansoni, 1958), pp. 83-102.

⁷ Cipolla, Carlo M., "The Economic Decline of Italy", in Idem, (ed.) *The Economic Decline of Empires*, Methuen&Co, London, 1970, pp. 196-197.

⁸ Eric Dursteler, "Commerce and coexistence: Veneto-Ottoman trade in the Early Modern Era, p. 105-106.

Historiografia bashëkohore, duke filluar me Ömer Lûtfi Barkan, nisi një fazë të re në studimin e historisë osmane mbështetur në burimet e pasura të arkivave turke me qëllim të qasjes sasiore dhe krahasimtare.⁽⁹⁾ Kjo prijje u mbështet nga historianë të vendeve ballkanike nga vitet 1950, duke sjellë botimin e një numri të madh burimesh që kanë nxitur hulumtimet në historinë demografike, urbane dhe agrare të periudhës osmane.⁽¹⁰⁾

Nuk ka shumë studime dhe përpjekje të historianëve shqiptarë në drejtim të historisë ekonomike të territoreve shqiptare në mesjetë dhe në periudhën osmane. Punimet e periudhës 1945-1990 mbi historinë agrare si për shembull ato të Selami Pulahës⁽¹¹⁾, Përparime Hutës⁽¹²⁾, Petrika Thëngjillit⁽¹³⁾, edhe pse nuk arrijnë të sjellin një panoramë të qartë, janë mjaft të pasura në detaje dhe përbëjnë burime të vlefshme që mund të shërbejnë edhe sot për të krijuar një ide të përgjithshme mbi kahet e zhvillimit ekonomik. Nga ana tjetër, punimet e Zija Shkodrës që trajtojnë historinë e zhvillimit zejtar-industrial, janë mjaft të detajuara dhe njëkohësisht për vetë natyrën e temës arrijnë të anashkalojmë kufizimet ideologjike të kohës, duke sjellë një panoramë më të qartë, më të lidhur dhe të njëtrajtësuar harmonikisht mes analizës dhe sintezës.⁽¹⁴⁾

⁹ Ö. L. Barkan, 'Essai sur les données statistiques des registres de recensement dans l'Empire ottoman aux XVe et XVIe siècles', *Journal of Economic and Social History of the Orient* 1 (1957) p. 10.

¹⁰ Mes të tjerave shih: Branislav Djurdjev, *Turska vlast u Crnoj Gori u XVI i XVII veku*. Prilog jednog nerešenot pitanju iz naše istorije (Sarajevo, 1953); Bistra A. Cvetkova, *Les institutions ottomanes en Europe* (Ëiesbaden, 1978); Olga Zirojević, *Tursko vojno uredjenje u Srbiji (1459-1683)* (Belgrade, 1974); Aleksandar Stoianovski, *Gradovite na Makedonija od kraiot na XIV do XVII vek*. Demografski prouchuvania (Skopje, 1981); Vasiles Demetriades, *Topografia tes Thessalonikes kata ten epoche tes Tourkokratias 1430-1912* (Thessaloniki, 1983).

¹¹ Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare* (shek. XV-XVI), Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1988.

¹² Përparime Huta, *Fshati ne sanxhakun e Shkodrës në shek. XV-XVI : veshtrim mbi demografinë dhe ekonominë*, Tirane: Instituti i Historisë, 1990.

¹³ Petrika Thëngjilli, *Renta feudale dhe evoluimi i saj në viset shqiptare (XVII-XVIII)*, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1990.

¹⁴ Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare : (shekujt XV - XX)*, Tirane, 1973.

Paqja e qëndrueshme veneto-osmane, e cila qëndroi pothuajse e paprekur për një shekull e gjysmë, deri në mesin e shekullit XVII, e vendos rajonin ekonomik shqiptar në pikëlidhjen, në mesin e pashmagshëm të bashkëveprimit ekonomik mes dy gjigandëve ekonomikë të kohës. Në mënyrë të përmbledhur mund të përmendim një numër treguesish që tregojnë pikërisht atë që Henri Pirenne e ka theksuar para pothuaj një shekulli: tregtia është ngjitëse, dhe fqinjësia me vende më të zhvilluara ishte një fat në aspektin ekonomik.⁽¹⁵⁾

Ndërkohë që ekonomia rajonale shqiptare zhvillohej me ritme të shpejta në mesin e këtij bashkëpunimi ekonomik dhe paqeje politike mes Venedikut dhe Perandorisë Osmane, rënia e këtyre dy ekonomive në mesin e shekullit XVII që përkon edhe me prishjen e paqes politike mes tyre, do të vazhdojë të sjellë efekte pozitive për ekonominë shqiptare.

Dy aspekte duhen marrë në konsideratë në këtë këndvështrim. Së pari, tërheqja e Venedikut nga tregtia me Stambollin dhe Azinë e Vogël, vërtet e zvogëloi vëllimin e tregtisë së saj, por kjo nga ana tjetër e shndërroi atë nga një fuqi tregtare mesdhetare në një fuqi tregtare në Adriatik dhe në Jon, duke e sjellë më afër tregjeve shqiptare. Në Shqipëri, venedikasit edhe pse nuk gjenin prodhimet osmane të së njëjtës cilësi si në Stamboll, gjenin prodhime të njëjta apo të ngjashme me çmime më të leverdisshme dhe me kosto transporti më të vogla.⁽¹⁶⁾ Kjo rritje e rëndësisë së tregut shqiptar vërehet më së miri në hapjen e konsullatave në portet shqiptare që kishin synim lehtësimin e tregtisë ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut, pikërisht në gjysmën e dytë të shek. XVII.⁽¹⁷⁾

Mirëpo po aq me rëndësi është fakti se interesi ekonomik i Shqipërisë ishte edhe në objektivat e fuqive të tjera europiane,

¹⁵ Henri Pirenne's *Economic and Social History of Medieval Europe*, (1937), p. 5.

¹⁶ Një kontribut i rëndësishëm mbi këto marrëdhënie është edhe Alvin Saraçi, *Il commercio adriatico di Scutari con la Repubblica di Venezia nei secoli XVII-XVIII*, tezë doktore dhe mbrojtur në universitetin Ca'Foscari, Venezia dhe në Institutin e Historisë, QSA, Tiranë, 2016.

¹⁷ La decadenza della «scala» di Spalato in questo contesto a causa della guerra di Creta (1645-1669) faceva emergere i porti albanesi di Durazzo, Scutari, Valona e San Giovanni di Medua insieme a quello di Cattaro. Saraçi, *Il commercio adriatico di Scutari*, po aty.

veçanërisht francezëve e holandezëve që kishin shqyrtuar mundësinë e hapjes së konsullatave në Durrës që në vitet 1640. Më pas, edhe Ulqini ishte pjesë e interesit ekonomik francez, ndërsa në Shkodër venedikasit hapën një përfaqësi konsullore që varej nga konsullata e Durrësit.⁽¹⁸⁾

Pjesë e këtij procesi ishte edhe prania e shtuar e tregtarëve shqiptarë në Venecia që shkon duke u bërë gjithnjë e më e rëndësishme gjatë gjithë periudhës në shqyrtim. Në shekullin XVII kolonia e tregtarëve nga Perandoria Osmane ishte e akomoduar tashmë në atë që quhej “fondaco dei turchi”, ngjashëm me modelin e “fondaco dei tedeschi”.⁽¹⁹⁾

Së dyti, dobësimi i pushtetit qendror osman dhe dekadencia ekonomike e shtetit osman jo vetëm e zvogëloi konkurrencën e tregtarëve nga zonat e Mesdheut Lindor në tregtinë me Venedikun, por ky dobësim i pushtetit qendror, bëri të mundur rënien e kontributit fiskal të trojeve shqiptare drejt qendrës politike, pra Stambollit. Në këtë mënyrë, dalja në pah dhe forcimi i vazhdueshëm politik i elitave lokale erdhi si pasojë e përvetësimit dhe e përdorimit vendor të taksave që më përpara shkonin direkt drejt kryeqytetit osman. Këto taksa të mbajtura për nevojat e ekonomisë rajonale shqiptare bënë të mundur projektimin dhe kryerjen e projekteve madhështore në infrastrukturë, ku spikasin urat e gurta mbi lumenjtë kryesorë të Shqipërisë dhe në nyjet kryesore të rrjetit rrugor. Po ashtu edhe investimet në vepra arkitekturore të karakterit social e fetar, si hamame, hane, xhami, kisha janë dëshmi e kësaj.

¹⁸ J. Spon, G. Wheler, *Viaggi di Mons. Spon, per la Dalmazia, Grecia, e Levante, portati da Franzese da D. Casimiro Freschot Casinense*, Bologna, 1688, p. 31.

¹⁹ La loro presenza numerosa nella città di Venezia dà prova che gli albanesi erano intermediari dei commerci tra la Sublime Porta e Venezia. Paolo Preto, *Venezia e i turchi*, Firenze, 1975, 85-6.